

Dalës-bledhje

Nr. 1-67
Pr.

Data 23.03.2021
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

1. Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.-I-350, të dt.11.12.2020, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere për përkrahjen e banorëve të prekur me Covid 19, të Komunës së Obiliqit
2. Të subvencionohen në vlerën prej 100 €, çdo banorë i prekur nga Covid 19, (i rezultuar pozitiv dhe i trajtuar nga Institucionet Shëndetësore sipas listës me testimet PCR, të IKSHP-së.)
3. Të subvencionohen në vlerën prej 300 €, çdo familje, të cilat kanë humbur anëtar me Covid 19.
4. Ky vendim vlen prej fillimit të pandemisë Mars 2020 – e deri në përfundim të pandemisë.
5. Mjetet e dedikuara për këto kategori janë të hyra vetanake.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes Komisionit komunal.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'idërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- DFEZH
- MPL
- Anëtarëve të KK
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

Udhëzimi

Nr. 1-350

Data: 11/12/2020
Në emër të:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit nr.II-1633 të dt.09.12.2020, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.11.12.2020, mori këtë:

V E N D I M


1. Të ndahen mjeteve buxhetore në vlerën prej 90,000.00€ nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere , për përkrahjen e banorëve të prekur me Covid-19 për qytetarët e Komunës së Obiliqit (me vendbanim të përhershëm).
2. Të subvencionohet në vlerë prej 100 € çdo banorë i prekur nga Covid-19 (i rezultuar pozitiv dhe i trajtuar nga Institucionet Shëndetësore, sipas listës me testimet PCR të IKSHP-së).
3. Të subvencionohen në vlerë prej 300€ çdo familje , të cilat kanë humbur anëtar me betejën e Covid-19.
4. Ky vendim vlen prej fillimit të pandemisë Mars 2020 – e deri në përfundim të pandemisë.
5. Mjetet e dedikuara për këto kategori janë të hyra vetanake .
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi , Financa dhe Zhvillim dhe Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale përmes Komisionit Komunal .
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nën kryetarit
- Kryesuesit
- DSHMS-së
- DEFZH-së
- Anëtarëve të KK-së
- Arkivit

M

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Grafës Klazur

Nr. 1-347

Data 09.12.2020

000110 000000




Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 44 dhe 41 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 7 pika 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 (MAPL) për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës si dhe nenit 49 të Statutit të Komunës, kërkesa e Kryetarit të Komunës nr 11-1633 dt.09.12.2020 caktoj:


Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës me dt.11.12.2020 (e premtë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

REND DITE

1. Ndarjen e mjeteve financiare për ndihmë banorëve të prekur nga pandemi Covid 19'



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri

NUMERI:

11-1633

Data: 09.12.2020


Kategoria:



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	08/12/2020
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashi
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal z. Burim Gërguri
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkes



I nderuar,

Duke e parë situatën e rëndë të shkaktuara nga COVID19 për banorët e Komunës tonë, ashtu siq u dakorduam sot në takim me ju dhe Shefat e grupeve të gjitha partive në Kuvendin Komunal, kërkoj që të thirrni një seancë të jashtëzakonshme për të ju dalë në ndihmë banorëve të prekur nga COVID 19

Me respekt,